

Duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Gjykatat;<sup>1</sup> nenit 24 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;<sup>2</sup> Regullores për veprimtarinë e brendshme të gjykatave dhe Doracakut për menaxhimin e gjykatave model, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi, pas marrjes së mendimit të gjyqtarëve të kësaj Gjykate, në kolegjiunin e mbajtur më datë 10 janar 2022, përcakton :

## **PLANIN VJETOR TË PUNËS SË GJYQITARËVE DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË GJILAN PËR VITIN 2022**

### **ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE NË GJILAN**

#### **NENI 1**

Organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Themelore në Gjilan, do ta udhëheqë Kryetari i Gjykatës Ramiz Azizi deri në fund të mandatit.

Zëvendës i Kryetarit të Gjykatës, do të jetë gjyqtari Aziz Shaqiri.

#### **NENI 2**

Për kryerjen e funksioneve gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjilan, do të funksionojnë këto departamente :

1. Departamenti i krimeve të rënda;
2. Departamenti i përgjithshëm dhe
3. Departamenti për të mitur.

Në kuadër të Departamentit të përgjithshëm, do të funksionojnë :

1. Dega penale penale;
2. Dega civile dhe
3. Divizioni për kundërvajtje.

Në çdo departament,degë dhe divizion do të caktohet nga një gjyqtar si udhëheqës i departamentit/degës-divizionit përkatës.

#### **NENI 3**

<sup>1</sup> Ligji për gjykatat, nr.03/L-199, i datës 22 korrik 2010.

<sup>2</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr.03/L-223, i datës 30 shtator 2010.

Udhëheqësit e departamenteve do t'i raportojnë së paku një herë në tre muaj për punën e departamenteve përkatëse Kryetarit të Gjykatës.

Pjesë e raporteve të udhëheqësit të departamentit të përgjithshëm do të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të degëve dhe divizioneve.

Kryetari i Gjykatës mund të kërkojë nga udhëheqësit e departamenteve/degëve e divizioneve që të paraqesin raporte mujore ose raporte për ecurinë e lëndëve të natyrave të veçanta.

#### **NENI 4**

Në Gjykatën Themelore në Gjilan, duke përfshirë edhe degët e saja, do të punojnë 34 gjyqtarë të sistemuar në departamente /degë dhe divizione si vijon :

Në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Gjilan do të punojnë 23 gjyqtarë të cilët janë të ndarë në degë e divizione.

Në Departamentin e Krimeve të Rënda do të punojnë 6 gjyqtarë:

1. Ramiz Azizi,
2. Aziz Shaqiri
3. Agim Ademi,
4. Sabedin Mushica,
5. Naser Maliqi,
6. Islam Thaç

Në departamentin për të mitur do të punojnë 2 gjyqtar

1.Sahit Boroci dhe

2.Behar Ymeri( si alternativë)

Në Degën Penale të Departamentit të Përgjithshëm do të punojnë 6 gjyqtarë:

1. Behar Ymeri,
2. Luljetë Shabani,
3. Mevlide Shabani,
4. Snezhana Mihajlovic,
5. Veli Kryeziu dhe
6. Rilind Sermahaj

Në Degën Civile të Departamentit të Përgjithshëm, do punojnë 9 gjyqtarë:

1. Berat Spahi,
2. Blerim Beshtica,
3. Besnik Pireva,
4. Venhar Salihu,

5. Myrvete Alidema
6. Milorad Mitkovic dhe
7. Flora Qerimi,
8. Kaltrina Haliti dhe
9. Liridona Haziri-Mustafa (sapo të kthehet nga pushimi i lehonisë-e transferuar përkohësisht me vendim të KGJK-së)

Në Divizionin për Lëndët Përmbartimore, do të jenë 2 gjyqtar:

1. Venhar Salihu e
2. Gazmend Ajvazi

Në Divizionin e Kundërvajtjes të Departamentit të Përgjithshëm do të punoj 1 gjyqtar:

1. Menderes Behluli.

Me qëllim të zgjidhjes më efektive të lëndëve, gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda, do të mund të angazhohen edhe në zgjidhje të lëndëve nga departamentet tjera.

Në Departamentin për të Mitur do të punojnë gjyqtari Sahit Borovci, kurse, në rastet përjashtimit të tij dhe mungesës së tij (pushimeve të ndryshme, trajnimeve, etj.), atëherë, do të angazhohet gjyqtari Behar Ymeri. Poashtu këta gjyqtar mund të angazhohen edhe në punë-zgjidhjen e lëndëve nga degët tjera.

## **NENI 5**

Për udhëheqës të departamenteve/degëve dhe të divizioneve janë caktuar:

1. Agim Ademi, udhëheqës i Departamentit të Krimeve të Rënda;
2. Berat Spahiu, udhëheqës i Departamentit të Përgjithshëm;
3. Sahit Boroci, udhëheqës i Departamentit për Mitur;
4. Millorad Mitkoviqi, udhëheqës i Degës Civile;
5. Behar Ymeri, udhëheqës i Degës Penale dhe
6. Menderes Behluli, udhëheqës i Divizionit për Kundërvajtje.

## **NENI 6**

Kryetari i Gjykatës, vendos sipas kërkesës për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja; urdhrat në procedurë paraprake, si dhe rastet e tjera kur me ligj është përcaktuar kompetenca e kryetarit të gjykatës themelore.

Kryetari i Gjykatës, Ramiz Azizi, do t'i gjykojë rastet të cilat ka në punë, mirëpo, sipas nevojës dhe mundësive do të mund angazhohet edhe në trupa gjykues dhe do të mund edhe të pranojë lëndë të reja.

## **ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË KAMENICË**

### **NENI 7**

Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, do të funksionojnë 2 degë e një divizion:

1. Dega penale;
2. Dega civile dhe
3. Divizioni për kundërvajtje.

### **NENI 8**

Gjyqtari mbikëqyrës i Degës në Kamenicë, është caktuar gjyqtari Sadri Krasniqi. Pjesë e këtij plani do të jetë dhe vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për caktimin e gjyqtarit mbikëqyrës në Degën e Kamenicës.

### **NENI 9**

Në Degën e çështjeve penale janë caktuar këta gjyqtarë:

1. Sadri Krasniqi dhe
2. Valbona Dërvodeli.

Poashtu kata dy gjyqtar do ti kryejnë edhe lëndët e divizionit kundërvajtës.

Udhëheqëse e Divizionit penal do të jetë gjyqtarja Valbona Dërvodeli.

Në Degën për çështje civile janë caktuar gjyqtarët Artan Abazi dhe Nada Stanojeviqi, e cila njëherit do të jetë edhe udhëheqëse e këtij Divizioni.

Gjyqtarët e përcaktuar në kuadër të një dege a divizioni varësisht prej nevojave do të angazhohet edhe në çështjet tjera.

## **ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË VITI**

### **NENI 10**

Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në Viti, do të funksionojnë 2degë dhe një divizion:

1. Dega penale;
2. Dega civile dhe
3. Divizioni për kundërvajtje.

#### **NENI 11**

Gjyqtari mbikëqyrës i Degës në Viti, është caktuar gjyqtari Alush Sinani. Pjesë e këtij plani do të jetë dhe vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për caktimin e gjyqtarit mbikëqyrës në Degën e Viti.

#### **NENI 12**

Në Degën e çështjeve penale janë caktuar këta gjyqtarë:

1. Blerina Jakupi-Ramnadani,
2. Drane Simani dhe
3. Nexhat Aliu

Udhëheqës i Degës penale është caktuar gjyqtari Nexhat Aliu.

Gjyqtar në Divizionin për çështje civile janë caktuar gjyqtarët :

1. Alush Sinani,
2. Raif Fazliu dhe
3. Arben Xheladini

Udhëheqës i Degën për çështjeve civile është caktuar Raif Fazliu.

Në Divizionin për kundërvajtje –lëndët e kundërvajtjes do ti kryejnë gjyqtarët e degës penale në mënyrë proporcionale.

Gjyqtarët e përcaktuar në kuadër të një dege/divizioni varësisht prej nevojave do të angazhohen edhe në çështje tjera.

### **ORGANIZIMI I PUNËS NË GJYKATËN THEMELORE TË GJILANIT, DEGA NË NOVOBËRDË**

#### **NENI 13**

Në kuadër të Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, do të funksionojnë 2 degë e një divizion:

4. Dega penale;
5. Dega civile dhe
6. Divizioni për kundërvajtje.

#### **NENI 14**

Gjyqtari mbikëqyrës i Degës në Novobërdë, do të jetë gjyqtari si ushtrues detyre Venhar Salihu, i cili këtë detyrë e kryan krahas angazhimit në Gjykatën Themelore në Gjilan si gjyqtar civilist.

Pjesë e këtij plani do të jetë dhe vendimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për caktimin e gjyqtarit mbikëqyrës në Degën e Novobërdës ku konkursi tani veq është i mbyllur .

#### **NENI 15**

Në Degë e çështjeve penale është caktuar përkohësisht gjyqtari Sabedin Mushica, dhe ate punon një ditë në javë dhe ate deri sa të zgjedhet gjyqtari mbikëqyrës në këtë degë, e do të jetë edhe udhëheqëse i këtij Divizioni.

Në Divizionin e çështjeve civile dhe kundërvajtje është caktuar gjyqtari.

1. Boban Aleksic

Udhëheqës i Degës për çështje civile dhe divizionit kundërvajtës është caktuar gjyqtari Boban Aleksic

### **PËRBËRJA E TRUPEVE GJYKUESE DHE KOLEGJEVE**

#### **NENI 16**

Gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Gjilan, do të angazhohen si anëtarë të trupit gjykues në Departamentin e Krimeve të Rënda, ata të departamentit të krimeve të rënda, për të mitur si dhe të degës penale.

Kolegji shqyrtues; Paneli për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit dhe kolegjet tjera, do të formohen nga gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda dhe Departamentit të Përgjithshëm-dega penale dhe të departamentit për të mitur, sa herë që ka nevojë për të vendosur për çdo për çështjet e parashikuara me Kodin e Procedurës Penale.

### **NDARJA E LËNDËVE**

#### **NENI 17**

Ndarja e lëndëve në punë tek secili gjyqtarë bëhet në mënyrë proporcionale. Gjyqtarëve lëndët ju ndahen sipas sistemit automatik të SMIL-it, siç është përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm të Gjykatave, si dhe Rregulloren e sistemit SMIL, poashtu edhe lëndët e natyrës urgjente do të ndahen me këtë sistem(SMIL). Nëse një gjyqtari të cili i është ndarë lënda për ta gjykuar duhet përjashtuar për arsye të ndryshme ligjore, atëherë, atëherë lënda i ndahet gjyqtarit tjetër sipas sistemit SMIL. Të gjithë gjyqtarët e caktuar në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe të Departamentit të Përgjithshëm (Divizioni Penal dhe për Kundërvajtje) do të jenë me radhë gjyqtarë në kujdestari në procedurë paraprake. Në Departamentin për të Mitur kujdestar do të jenë gjyqtarët Sahit Boroci sidhe Behar Ymeri në rastet eventuale ku nuk mund të veprojnë gjyqtari Sahit Boroci. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë Udhëheqësit e Departamenteve/Divizioneve.

### **RADHA E ZGJEDHJES SË LËNDËVE NENI 18**

Në parim lëndët zgjidhen sipas radhës së arritjes në gjykatë. Përjashtim nga kjo rregull, bëjnë lëndët me përparësi ligjore të cilat duhet të zgjidhen brenda afateve ligjore ose afateve të arsyeshme, me kusht që edhe ato duhet të vendosen sipas radhës së arritjes në gjykatë. Lëndëve sipas strategjisë Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe veprave penale korrupsioni zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare do t'ju ipet përparësi e veçantë.

### **MBLEDHJET E KOLEGJIUMEVE TË GJYQTARËVE DHE STAFIT ADMINISTRATIV NENI 19**

Në çdo fillim të muajit do të mbahet mbledhje e përbashkët e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Gjiilan, me gjyqtarët që punojnë në Gjilan. Gjithashtu, edhe degët e Gjykatës Themelore në Gjilan, në fillim të çdo muaji do të mbajnë mbledhje me gjyqtarët që punojnë në degët përkatëse. Në këto mbledhje do të paraqiten raportet e punës për secilin gjyqtarë veç e veç, por do të mund të diskutohet dhe vendoset edhe për çështje tjera.

Kryetari i Gjykatës sa herë që e sheh të nevojshme për të diskutuar dhe vendosur për çështje të caktuara mund të mund të mbajë mbledhje me gjyqtarët e departamenteve, degëve e divizioneve veq e veq.

Udhëheqësit e departamenteve së paku çdo tre muaj do mbajnë mbledhje me gjyqtarët e departamentit përkatës.

Në fund të vitit 2022, apo në fuillim të vitit 2023, do të mbahet edhe mbledhja e përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe degëve të saja.

**ORGANIZIMI I PUNËS SË ADMINISTRATËS TË GJYKATËS THEMELORE  
NË GJILAN DHE DEGËT E SAJ  
NENI 20**

Menagjimi i punëve administrative, teknike dhe të sigurimit të objekteve do të bëhet nga Administratorja e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe nga ndihmës administratorët e kësaj Gjykate të cilët janë të detyruar që t'i raportojnë Administratorës për punën e tyre, e cila njihërit e mbikëqyr punën e tyre menaxheriale.

Administratorja dhe Zëvendësadministratorët së paku çdo tre muaj do të mbajnë takime, për të diskutuar dhe vendosur për çështje që ndërlidhen me kompetencat e tyre.

Administratorja për çdo javë do të mbajë mbledhje me shefat e zyrave.

Të gjithë stafi administrativ i Gjykatës Themelore në Gjilan, detyrohen që t'i përmbahen orarit të punës dhe gjatë orarit të punës duhet që t'i mbajnë me vete në vende të dukshme kartat zyrtare të identitetit.

**NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E PLANIT VJETOR  
NENI 21**

Ky plan vjetor mund të ndryshohet dhe plotësohet nga Kryetari i Gjykatës varësisht nga nevoja për organizimin më të mirë të punëve, zgjedhjen më efektive të lëndëve dhe në rast të ndryshimit të strukturës së gjyqtarëve.

**ZBATIMI I KËTIJ PLANI  
NENI 22.**

Ky plan i punës do të filloj të zbatohet nga data 10 janar 2022.

Poashtu ku plan i punës do ti dërgohet Këshillit Gjyqësor të Kosovës për miratim(aprovim).

**Kryetari Gjykatës,  
Ramiz Azizi**

